




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 24 – 5882 – 2-2-1/C892
14 Nr. 466/24
Dt. 25.07.2024

KONTRATË SHËRBIMI
(kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi - Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **AMAZONA HOTEL** “sh.p.k. me seli në **Obiliq**, me **NRB: 810129157**, të cilën e përfaqëson **z. Gani Ferizi**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I SHËRBIMEVE**.
janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon: **Shërbime hoteliere për A.K. - Vushtrri** , me numër identifikues:

Nr. i Prokurimit	VU644	2	4	58	8	2	2	2	1
Nr. i brendshëm	644	2	2	0	5	4	2	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime me ushqim, pije dhe fjetje për personel dhe musafir të Komunës së Vushtrrisë**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-24-054-221**
- 1.2 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data **25.07.2024** ndërsa përfundon **24 muaj pas nënshkrimit të kontratës** respektivisht më dt. **24.07.2026** duke përfshirë edhe këtë datë, dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi/Kryesi i Shërbimeve, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasitë e tyre përkatëse.
- 1.4 Sasitë e shërbimeve dhe ose furnizimeve të saktësuara si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate nuk janë përcaktuar.
- 1.5 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

Ekzekutimi i shërbimeve do të bëhet më datën kur Porositësi – Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues e njofton me shkrim (e-mail) Kryesin e Shërbimeve, ndërsa Kryesi i Shërbimeve merr për obligim që shërbimet e porositura të ekzekutohen me prioritet të lartë, në cilësi, sasi dhe përshtatshmëri, ashtu si është bërë porosia respektivisht ashtu sikurse është saktësuar në Përshkrimin e Shërbimeve pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate. Inkotermi i zbatueshëm do të jetë **DDP¹** (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Vlera totale indikative e kontratës është : 57,000.00 Euro.

3.2 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve. Ato janë të prera dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve.

3.3 Sasitë e artikujve, si në pjesën II. Lista e Artikujve dhe Çmimeve, pjesë e kësaj Kontrate, nuk janë të parapara, dhe pragu plus/minus tridhjet përqind (30 %) nuk vlenë.

3.4 Nëse Urdhër blerjet tejkalojnë vlerën totale indikative të saktësuar në nenin 3 të kësaj Kontrate Publike Kornizë, pa marrë parasysh datën e skadimit të Kontratës Publike Kornizë të saktësuar në nenin 1 pika 1.1. të kësaj kontrate , Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

3.5 Pagesat do të bëhen : në pajtim me sasinë - e shërbimeve të porositura dhe të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës - Komisioni i Pranimit të shërbimeve i Autoritetit Kontraktues.

3.6 Shumat do të paguhen brenda jo më gjatë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës.

3.7 Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate dhe Kushteve tjera të saktësuar në Dosjen e Tenderit.

3.8 Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të shërbimeve të respektoj detyrimet e tija në mënyrë që shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që ekzekutimi i shërbimeve të porositura të bëhet në mënyrë profesionale duke garantuar përdorim adekuat dhe cilësor të ushqimit dhe / ose fjetjes, në mënyrë që të garantojnë cilësi të shërbimeve të pranueshme dhe komode.

Neni 4 Ligji i aplikueshëm

Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 5 Kualiteti

Kualiteti respektivisht cilësia e shërbimeve dhe / ose furnizimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6 Garancioni

Garancioni i cilësisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve është përgjegjësi ekskluzive e Kryesit të Shërbimeve.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.



Neni 8 Inspektimi dhe testimi

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes të çfarëdo artikulli që përgatitet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët dhe materialet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Kryesi i Shërbimeve i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kryesi i Shërbimeve nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Kryesin e Shërbimeve për vendimin e tij brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Njoftimi, respektivisht Porosia mund të bëhet edhe në afat më të shkurtër kur ekzekutimi i shërbimit paraqitet si i paplanifikuar ose emergjent, ndërsa Kontraktuesi duhet të pajtohet për këtë Porosi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

Autoriteti kontraktues mundet që të ndërpres Kontratën menjëherë pasi të konstatoi se Kryesi i Shërbimeve nuk po arrin ta përmbushë Kontratën në pajtim me përshkrimin Teknik të saktësuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Kryesi i Shërbimeve

Kryesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kryesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Kryesi i Shërbimeve nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 100 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kryesit të Shërbimeve duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Neni 14 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

14.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit

14.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



Neni 5 Komunikimet

15.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kryesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



15.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

15.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

15.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kryesin e Shërbimeve .

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna Vushtrri

Për: " Amazona Hotel "sh.p.k. – Obiliq

<i>Emri:</i>	Ilmi Azemi	<i>Emri:</i>	Gani Ferizi
<i>Pozita:</i>	Drejtor i Drejtorisë	<i>Pozita:</i>	Drejtor
<i>Nënshkrimi:</i>		<i>Nënshkrimi:</i>	
<i>Data:</i>	25.07.2024	<i>Data:</i>	25.07.2024
<i>Vula:</i>		<i>Vula:</i>	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenet	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit /kontratës do të emërohet me aktvendim të veçantë nga Zyrtari Kryesorë Administrativ, ditën e nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik
Obligimet e Operatorit ekonomik	12.4	Operatori ekonomik është i obliguar që të siguroj hapësirat e nevojshme dhe të ofroj shërbimet hoteliere cilësore në kohë sipas orarit të paraparë në porosinë e lëshuar nga menaxheri i kontratës.
		Të gjitha shërbimet hoteliere për ushqime (dreka dhe darka zyrtare) si dhe akomodim duhet të kryhen në një vend-objekt brenda hapësirës së njejtë.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës në kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
		Dokumenti – Polisa e sigurimit apo ndonjë dokument bankar të lëshuar nga kompania e sigurimeve apo ndonjë Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë:
		<ul style="list-style-type: none"> a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <i>[shëno shumen]</i> b) Përgjegjësia e pales së tretë <i>[shëno shumen]</i> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve : deri 100 % të vlerës së Sigurimit të Ekzekutimit. d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumen]</i> Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve :
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Shërbimet e kontraktuara, të përshkruara si në Specifikimin Teknik, do të bëhet vetëm në bazë të kërkesës me shkrim të Njesisë së Kërkesës – menaxheri i kontratës. Cilësia e shërbimeve do të mbikëqyret nga ana e Menaxherit të Kontratës i cili do të emërohet nga ZKA. Menaxheri, përmes Raportit të shkruar, duhet të konfirmoi dhe pranoi ekzekutimin e shërbimeve. Në Raport duhen të evidentohen të gjitha të dhënat relevante që janë të nevojshme për përcaktimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Kryesi i Shërbimeve. Asnjë pagesë në emër të Kryesit të shërbimeve nuk do të autorizohet- lejohet derisa nga Menaxheri i Kontratës i A.K. nuk është përpiluar Raporti për konfirmimin e zbatimit me sukses dhe në mënyrë cilësore të shërbimeve të porositura.

Pagesa	17.2	Pagesa për shërbimet e kryera, do të kryhet duke u bazuar në raportin e lëshuar nga Menaxheri i Kontratës. Pagesa për shërbimet e kryera, do të kryhen në fatin sa më të shkurtër kohor por jo më gjatë se 30 ditë pas datës së pranimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjegjës për pranim dhe protokolim të faturave i AK.-së.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Konform nenit 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shërbime Hoteliere per nevojat e AK për periudhën 24 mujore





me nr. prokurimi

: VU644 - 24 - 5832 - 221 dhe nr. brendshëm : VU644-24-054-221

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-ë	Çmimi total 70% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë A
1	Pogaçe	Copë	1	1.00	1.00	0.70	70%
2	Lëng ftohtë	Copë	1	0.50	0.50		
3	Lëng i ngrohtë	Copë	1	0.50	0.50		
4	Paragjell (djathë i bardh, kaçkavall, ullinj, përshatë) 150gr	Copë	1	2.50	2.50		
5	Paragjell e ngrohtë (sup pule, gjedhi apo peshku)	Copë	1	2.50	2.50		
6	Patate e fërguar 250gr	Copë	1	0.50	0.50		
7	Sallat e freskët, e përzier apo shope	Copë	1	2.50	2.50		
8	Ushqim kryesor (mish viqi 250 gr. Me perime të ndryshme)	Copë	1	9.50	9.50		
9	Pije jo alkoolike (lëngje të ndryshme 250ml)	Copë	1	1.50	1.50		
10	Pije jo alkoolike të ndryshme të gazuara -- kanaqe 330ml	Copë	1	1.50	1.50		
11	Ujë i pa gazuar 250ml	Copë	1	1.00	1.00		
12	Ujë i pa gazuar 500ml	Copë	1	1.20	1.20		
13	Ujë i gazuar 250ml	Copë	1	1.00	1.00		
14	Ujë i gazuar 500ml	Copë	1	1.20	1.20		
15	Çajë me filter i luleve të ndryshme	Copë	1	0.30	0.30		
16	Çajë i ftohtë 330ml në kanaqe	Copë	1	1.00	1.00		
17	Kafe të llojit të ndryshëm (makiato, espresso etj)	Copë	1	1.50	1.50		
18	Ëmbëlsirë i llojit të ndryshëm -150gr	Copë	1	2.50	2.50		
KATEGORIA A -TOTALI (1 - 18)							39,900.00
Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-ë	Çmimi total 15% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë B
19	Dhomë për fjetje për një person me mëngjes	Shërbim	1	40.00	40.00	0.15	15%
20	Dhomë për fjetje për dy person me mëngjes	Shërbim	1	50.00	50.00		
21	Dhomë për fjetje për një person me gjysmë pansioni (mëngjes dhe drekë)	Shërbim	1	50.00	50.00		
22	Dhomë për fjetje për dy person me gjysmë pansioni (mëngjes dhe drekë)	Shërbim	1	90.00	90.00		
23	Dhomë për fjetje me pansion të plotë për një person (mëngjes drekë dhe darkë)	Shërbim	1	70.00	70.00		
24	Dhomë për fjetje me pansion të plotë për dy person (mëngjes drekë dhe darkë)	Shërbim	1	120.00	120.00		
25	Salla të takimeve me kapacitet 6-200 persona, internet dedicate, laptop projektor, zërim, klimë sezonale	Shërbim	1	150.00	150.00		

KATEGORIA B -TOTALI (19 - 25)							8,550.00
Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 15% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë C
26	Pogaqe e shpise e pjekur ne prush , long l ftofte l shtëpis , mazë e ngroht e shtëpisë, pershute viqi riska , pershut pule tymosur , djath i bardhe , djath i mykur, kashkavall , moxarella , sallat pule , tranguj ,domate , laker e kuqe, tomatina, ullinjë , rukoll, sallat tuna, tarator, qep e kuqe , pica brod, brusketa me domate , brusketa me djath , patate te ferguara ,perime te ferguara , oriz me perime , fli me saq , krelan misri , - File Pule , Rolle Pule , Pjekje Viqi , Medalion Viqi, Kottlet Viqi, Dry Age, Muskuj Viqi, Tavë Prizreni, Tavë Elbasani, Pasta Boloneze , Pasta Carbonara , File Pule Vieneze , Qofte , Suxhuk , Trofte Skare	Shërbim	1	15.00	15.00	0.15	15%
KATEGORIA C -TOTALI (26 - 26)							8,550.00

Vlera Totale	57,000.00
--------------	-----------

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Gani Ferlzi
Pozita:	drejtor	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.07.2024	Data:	25.07.2024
Vula:		Vula:	



Sigurimi për Garanci Guarantee Insurance



Për

Seria |

1000112589

KOMUNA E VUSHTRRIË

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

Titulli Title	Shërbime Hoteliere		
Emri i Ofertuesit Name of the Bidder	AMAZONA HOTEL SH.P.K.	Prej From	25.07.2024
Adresa Address	Obiliq pn	Deri To	25.08.2026
Telefon Telephone	+38344454454	Shuma e sigurimit Insured sum	5,700.00 €
Numri i personal / biznesit Personal / business number	810129157	Primi Premium	213.75 €
Data e lëshimit Date of issue	25.07.2024	TVSH VAT	38.48 €
Numri i prokurimit Procurement number	VU644-24-5882-2-2-1	Totali për pagesë Total for payment	252.23 €
Lloji i kontratës Contract type	Garanci Kontrate		

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit Personal / business number	00000	Vendi City	VUSHTRRI
Adresa Address	VUSHTRRI	Telefon Telephone	044

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëqofëse ka fshehje apo shtrembërim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblimi në rast dëmi. Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje me me Ligjin nr.05/L-096 si dhe Nenin 9 të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të Bankës Qendrore të Kosovës

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage. The police officer declares that the origin of the funds is in accordance with Law no. 05/L-096 as well as Article 9 of the Regulation on the prevention of money laundering and terrorist financing of the Central Bank of Kosovo

Agjenti

Arber Statovci



Shënim: Te përshkrimi i emimeve duhet plotësohet vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F, ju duhet të plotësoni edhe shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin 0%-8%-apo-18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me emimin për njësi me TVSH, po ashtu emimin duhet ta shkruani me dy numra pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
-----	--------------------------	---------------	-------	-------------------------	----------------------	-----------------------------	------------------	------	--------------------

Shërbime Hoteliere për 24 muaj

Dreka zyrtare										Kategoria A				
A70%										(Kategoria A 70% e pikëve në vlerësim)				
1	Pogaçe	Copë	1	0.85	18.00	1.00	0.85	0.15	1.00					
2	Lëng ftohtë	Copë	1	0.42	18.00	0.50	0.42	0.08	0.50					
3	Lëng I ngrohtë	Copë	1	0.42	18.00	0.50	0.42	0.08	0.50					
4	Paragjell (djathë I bardh, kaçkavall, ullinji, përshatë) 150gr	Copë	1	2.12	18.00	2.50	2.12	0.38	2.50					
5	Paragjell e ngrohtë (sup pulë, gjedhi apo pesiku)	Copë	1	2.12	18.00	2.50	2.12	0.38	2.50					
6	Parate e fërguar 250gr	Copë	1	0.42	18.00	0.50	0.42	0.08	0.50					
7	Sallat e freskët, e përzier apo shope	Copë	1	2.12	18.00	2.50	2.12	0.38	2.50					
8	Ushqim kryesor (mish viqi 250 gr. Me perime të ndryshme)	Copë	1	8.05	18.00	9.50	8.05	1.45	9.50					
9	Pije jo alkoolike (lëngje të ndryshme 250ml)	Copë	1	1.27	18.00	1.50	1.27	0.23	1.50					
10	Pije jo alkoolike të ndryshme të gazuara – kanagë 330ml	Copë	1	1.27	18.00	1.50	1.27	0.23	1.50					
11	Ujë i pa gazuar 250ml	Copë	1	0.85	18.00	1.00	0.85	0.15	1.00					
12	Ujë i pa gazuar 500ml	Copë	1	1.02	18.00	1.20	1.02	0.18	1.20					
13	Ujë i gazuar 250ml	Copë	1	0.85	18.00	1.00	0.85	0.15	1.00					
14	Ujë I gazuar 500ml	Copë	1	1.02	18.00	1.20	1.02	0.18	1.20					
15	Çajë me filter i luleve të ndryshme	Copë	1	0.25	18.00	0.30	0.25	0.05	0.30					
16	Çajë i ftohtë 330ml në kanagë	Copë	1	0.85	18.00	1.00	0.85	0.15	1.00					
17	Kafe të llojit të ndryshëm (makiato, espresso etj)	Copë	1	1.27	18.00	1.50	1.27	0.23	1.50					
18	Ëmbëlsirë I llojit të ndryshëm - 150gr	Copë	1	2.12	18.00	2.50	2.12	0.38	2.50					
TOTALIA							27.29	4.91	32.20					
Shërbime Hoteliere të akomodimit										Kategoria B				
B15%										(Kategoria B 15% e pikëve në vlerësim)				
1	Dhomë për fjetje për një person me mëngjes	Shërbim	1	33.90	18.00	40.00	33.90	6.10	40.00					
2	Dhomë për fjetje për dy person me mëngjes	Shërbim	1	42.37	18.00	50.00	42.37	7.63	50.00					
3	Dhomë për fjetje për një person me gjysmë panjoni (mëngjes dhe drekë)	Shërbim	1	42.37	18.00	50.00	42.37	7.63	50.00					

4	Dhomë për fjetje për dy person me gjysmë pansioni (mëngjes dhe drekë)	Shërbim	1	76.27	18.00	90.00	76.27	13.73	90.00
5	Dhomë për fjetje me pansion të plotë për një person (mëngjes drekë dhe darkë)	Shërbim	1	59.32	18.00	70.00	59.32	10.68	70.00
6	Dhomë për fjetje me pansion të plotë për dy person (mëngjes drekë dhe darkë)	Shërbim	1	101.69	18.00	120.00	101.69	18.31	120.00
7	Salla të takimeve me kapacitet 6-200 persona, internet dedicate, laptop projektor, zërim, klimë sezonale	Shërbim	1	127.12	18.00	150.00	127.12	22.88	150.00
TOTALI B:							483.05	86.95	570.00


C15%	Tavolinë Suedeze	Kategoria C							(Kategoria C 15% e pikëve në vlerësim)
1	Pogaqe e shpisë e pjekur ne prush, long i toffe i shtëpis, mazë e ngroht e shtëpisë, peshute viji niska, peshut pule tymosur, djath i bardhe, djath i mykur, kashkavall, moxarella, sallat pule, tranguj, domate, lakër e kuqe, tomatoja, ullinjë, rukoili, sallat luna, tarator, qep e kuqe, pica brod, brusketla me domate, brusketla me djath, patate te ferguara ,perime te ferguara, oriz me perime, filli me sad, krelan misri, - File Pule, Rolle Pule, Pjekje Viji, Medalion Viji, Koilet Viji, Dry Age, Muskuj Viji, Tavë Prizreni, Tavë Elbasani, Pasta Boloneze, Pasta Carbonara, File Pule Vleneze, Qofite, Suxhuk, Trofite Skare	Shërbim	1	12.71	18.00	15.00	12.71	2.29	15.00
TOTALIC:							12.71	2.29	15.00

REKAPITULIMI

Kategoria	Përshkrimi	Gmimi total me TVSH në €	Gmimi total i peshuar
A70%	Dreka zyrtare	Kategoria A 32.20	22.54
B15%	Shërbime Hoteliere të akomodimit	Kategoria B 570.00	85.50
C15%	Tavolinë Suedeze	Kategoria C 15.00	2.25
<i>Gmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila duhet të shënohet në Formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.</i>			110.29

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

Numri i prokurimit: VU644-24-5882-2-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-24-054-221 Titulli: Shërbime Hoteliere

EMRI I OE:	"AMAZONA HOTEL SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT	TË OE: GANI FERIZI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	03.07.2024
VULA:	

